

Fletë informacion për personat qe dërgohen **detyrimisht** në një zyre kontakti «Integrim»

**Ju keni ardhur para pak kohe në kantonin e Bernës.
Ne ju urojmë mirëseardhje të përzemërt!**



Me bisedën e parë komuna juaj e re ju përshëndet dhe ju jep informacione të rëndësishme, të cilat do t' ju lehtësojnë të mësoheni me jetën e përditshme.

Duke u bazuar në ligjin për integrim të kantonit të Bernës komunitat në kantonin e Bernës që nga viti 2015 zhvillojnë një bisedë të parë me të huajat/të huajt e porsaardhur. Në këtë bisedë ju merrni informacione për jetën në komunë dhe për ofertat e integritit (kurse të gjuhës, vendtakime, shoqata dhe klube etj.).

Ju merrni dokumente informative dhe mësoni gjithashtu, se cilat janë të drejtat dhe detyrimet tuaja.



Nëse ju keni nevojë për më shumë informacione, komuna ju njofton tek një zyrë kontakti «Integrim».

Për shkak të kriterëve të ndryshme, të cilat janë të përfshira në Ligjin për integrim të kantonit Bernë (neni 5 par. 4 IntG), komuna do të vendosë nëse ajo ju çon më tej për një zyrë kontakti «Integrim».

Zyra e kontaktit «Integrim» është një këshillimore, e cila i përkeqëson të huajat dhe të huajt gjatë integritit.



Zyra e kontaktit «Integrim» ju kontakton dhe merret vesh me ju për një termin për një bisedë këshilluese falas.

Nëse komuna ju ka përcaktuar të vini në një zyrë të kontaktit «Integrim», atëherë zyra e kontaktit «Integrim» ju jep një termin brenda 5 javësh pas bisedës së parë. Ju do të pranoheni atje nga një këshilltar /këshilltar e/i kualifikuar , e cila/ i cili flet gjuhën tuaj amtare ose një tjetër gjuhë në të cilën ju mund të komunikoni mirë.

Këshilltarja/këshilltari mund t' ju ndihmojë p.sh. të gjeni një kurs të përshtatshëm të gjuhës, mund t' jua tregojë rrugën për t' i njohur diplomat tuaja ose për të organizuar një ofertë nxitëse për fëmijët tuaj.



Vetëm pasi keni qenë tek zyra e kontaktit «Integrim» kërkesa juaj për lejen e qëndrimit do të përpunohet më tej.

Pasi ju e keni vizituar zyrën e kontaktit «Integrim», autoriteti i migrimit vazhdon të përpunojë kërkesën tuaj për lejen e qëndrimit.

Sapo të aprovohet kërkesa juaj dhe të dhënat tuaja biometrike të jenë të regjistruara në një qendër për lëshimin e letërnjoftimeve, mund të lëshohet letërnjoftimi. Nga komuna ju do të merrni një ftesë për ta marrë letërnjoftimin.

Pikat e kontaktit «Integrimi» në kantonin Bernë

Ville de Berne

Centre de compétence Intégration de la ville de Berne
Effingerstrasse 33
3001 Berne
031 321 60 36
integration@bern.ch
www.bern.ch/integration

Emmental, Mittelland et Haute-Argovie

isa
Centre d'information pour étrangères et étrangers
Speichergasse 29
3011 Berne
031 310 12 72
beratung@isabern.ch
www.isabern.ch

Ville de Thoune et Oberland bernois

KIO, Centre de compétence Intégration Thoune-Oberland
Uttigenstrasse 3
3600 Thoune
033 225 88 00
kio@thun.ch
www.thun.ch/kio

Jura Bernois, Seeland et Bienne

Service spécialisé de l'intégration
Rue de la Gare 50
2502 Bienne
032 326 12 17
integration@biel-bienne.ch
www.biel-bienne.ch/integration-f